

MARREDHENIET E PRONESISE

Ligj nr. 8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara"

II.1h

Faqe 1

LIGJ

Nr. 8312, datë 26.3.1998

PER TOKAT BUJQESORE TE PANDARA

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1

Ky ligj ka për objekt rregullimin juridik të tokave bujqësore të pandara dhe të tokave bujqësore të refuzuara nga familjet dhe që nuk pranojnë të marrin aktin e pronësisë apo të përdorimit sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën" dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në zbatim të tij.

Neni 2

Toka bujqësore të pandara konsiderohen sipërfaqet e kadastruara në zërin tokë bujqësore më 1.8.1991, brenda kufijve të një njësie të caktuar administrative (fshat, komunë ose bashki që ka toka bujqësore jashtë vijave kufizuese), të cilat nuk janë ndarë nga komisionet e tokave ose që janë refuzuar të merren nga familjet apo individë të ndryshëm dhe që nuk kanë ndryshuar zërin kadastral deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 3

Tokat bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore që nuk janë ndarë për arsye të kufizimit të normës për frymë, mbeten disponibël shtetëror dhe nuk janë objekt i këtij ligji.

Neni 4

Tokat bujqësore që shtrihen në zonën me përparësi të zhvillimit turistik trajtohen sipas akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Neni 5

Sipërfaqet e tokave bujqësore të pandara administrohen nga këshilli i komunës ose bashkisë, që kontrollon komisionet e tokave të fshatrave për rindarjen e tyre, sipas kriterëve ligjore.

Neni 6

Pushtimi, shpërdorimi a dëmtimi i tokave bujqësore, objekt i këtij ligji, nga persona fizikë ose juridikë, përbën veper penale dhe dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal.

Neni 7

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet këshilli i komunës ose i bashkisë dhe komisionet e tokave të të gjitha niveleve.

Neni 8

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë aktet nënligjore përkatëse për zbatimin e këtij ligji.

Neni 9

Ligji 8047, datë 14.12.1995 "Për administrimin e tokave bujqësore të refuzuara" dhe aktet nënligjore, që kanë dalë në zbatim të këtij ligji, shfuqizohen.

MARREDHENIET E PRONESISE

Ligj nr. 8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara"

II .1h

Page 2

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 2037, datë 9.4.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.